 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena “UKSHIN HOTI”	
Pranuar më dt. 20.01.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-47/A



Universiteti – University
“Ukshin Hoti”
Prizren

STRATEGJIA PËR MONITORIMIN DHE ZVOGËLIMIN E
BRAKTISJEVE

Prizren, 2023

PËRMBAJTJE

Hyrje.....	2
Rezultatet nga monitorimi i braktisjeve në 4 vitet e fundit.....	3
Raporti i braktisjeve të studimeve ndër vite dhe arsyet.....	4
Raportet e braktisjeve të studimeve nëpër njësi akademike.....	5
Krahasimi me rajonin dhe Evropën.....	6
Strategjitë e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren ,për zvogëlimin e braktisjeve.....	7
Këshillimi akademik.....	7
Këshillat psikologjike.....	7
Angazhimi i studentëve tutor.....	7
Qendra e Karrierës mbështetje për soft-skills.....	7
Mësimi Hibrid.....	8
Ligjërata shtesë të individualizuara.....	8
Plani i Veprimit 2023.....	9

HYRJE

Braktisja e studimeve në arsimin e lartë është dukuri që po shqetëson universitetet dhe autoritetet në mbarë botën. Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, ka vendosur mekanizmat për monitorimin e braktisjeve duke nxjerrë edhe shkaqet më të shpeshta që po shkaktojnë braktisjen e hershme të Universitetit nga të rinjtë.

Kjo strategji është hartuar duke marrë për bazë modele të ndryshme dhe qasjet për të adresuar këtë dukuri. Braktisja është një dukuri globale dhe strategjitë në përgjithësi janë universale. Ne jemi munduar që nga rezultatet që kanë dalë nga monitorimi i braktisjeve të hartojmë një strategji për zvogëlimin e braktisjeve përmes mekanizmave dhe aktiviteteve që mund të realizohen në kontekstin ku vepron Universiteti duke marrë për bazë gjendjen socio-ekonomike të vendit dhe mundësive që ka Universiteti në këtë stad të zhvillimit. Është me rëndësi të theksohet se Kosova si shtet ende nuk e ka adresuar këtë çështje në nivelin e arsimit të lartë, edhe pse në nivelin parauniversitar është punuar në këtë drejtim.

Bashkëngjitur me këtë Strategji është edhe Plani i Veprimit, ku janë planifikuar një sërë aktiviteteve që do të ndërmerren brenda një viti akademik.

Qendra e Karrierës është mekanizmi kryesor në nivel Universiteti që bënë monitorimin e braktisjeve dhe së bashku me Zyrën e Cilësisë dhe Komisionin Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Komisionet për Sigurimin e Cilësisë në nivel të njësive akademike, kanë analizuar të dhënat nga monitorimi i braktisjeve për vite dhe në bazë të rekomandimeve është hartuar Strategjia në nivel Universiteti për adresimin e dukurisë së braktisjeve së studimeve.

Universiteti do të bëjë përpjekje që të zvogëlojë braktisjet e studimeve nga studentët përmes:

- **Këshillimit akademik**
- **Angazhimit të studentëve tutor**
- **Ofrimit të këshillave psikologjike**
- **Mbështetjes gjatë studimeve përmes Qendrës së Karrierës**
- **Organizimit të mësimit hibrid**
- **Organizimit të ligjëratave shtesë të individualizuara për studentët që hasin në vështirësi**

REZULTATET NGA MONITORIMI I BRAKTISJEVE N4 VITET E FUNDIT


Gjatë vitit akademik 2020/2021, Universiteti "Ukshin Hoti" ka pas 416 studentë apo 6 studentë më shumë për nga viti akademik 2019/2020 që ishte 410 dhe 59 studentë më pak për nga viti akademik 2018/2019 që ishte 475, që kanë braktisur studimet. Në vitin akademik 2020/2021, 174 studentë femra dhe 260 studentë meshkuj kanë braktisur studimet. 56 studentë (15 femra dhe 41 meshkuj) kanë ikur nga departamenti i Administrim Biznesit, 53 studentë (15 femra dhe 39 meshkuj) nga departamenti Menaxhment Ndërkombëtar, 101 studentë (47 femra dhe 54 meshkuj) nga departamenti Juridik, 39 studentë (5 femra dhe 34 meshkuj) nga departamenti Software Design, 31 studentë (3 femra dhe 28 meshkuj) nga departamenti TIT (shqip), 6 studentë (meshkuj) nga departamenti TIT (boshnjakisht), 7 studentë (4 femra dhe 3 meshkuj) nga departamenti TIT (turqisht), 14 studentë (8 femra dhe 6 meshkuj) nga departamenti Program Fillor (shqip), 7 studentë (5 femra dhe 2 meshkuj) nga departamenti Program Fillor (boshnjakisht), 15 studentë (14 femra dhe 1 mashkull) nga departamenti Program Parafillor (shqip), 1 student (femër) nga departamenti Program Parafillor (boshnjakisht), 6 studentë (femra) nga departamenti Program Parafillor (turqisht), 21 studentë (12 femra dhe 9 meshkuj) nga departamenti Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 38 studentë (20 femra dhe 18 meshkuj) nga departamenti Gjuhë dhe Letërsi Angleze, 26 studentë (17 femra dhe 9 meshkuj) nga departamenti Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, 4 studentë (meshkuj) nga departamenti Agrobiznes dhe 5 studentë (2 femra dhe 3 meshkuj) nga departamenti Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit. Në total, 174 femra dhe 260 meshkuj kanë braktisur studimet gjatë vitit akademik 2020-2021. Tabela në vazhdim paraqet këto informacione, përfshirë edhe braktisjet për vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 sipas departamenteve dhe sipas gjinisë.

Në tabelën pasardhëse janë paraqitur arsyet më të zakonshme të braktisjes së studimeve. Siç mund të shihet, për të tri vitet me radhë, arsyeja kryesore e braktisjes së studimeve është migrimi jashtë vendit (57,37% për vitin 2020-2021, 52,20% për vitin 2019-2020 dhe 45,89% për vitin 2018-2019). Kjo arsye ka vazhduar të rritet gradualisht për secilin vit. Në vitin 2020 arsyeja e dytë kryesore e braktisjes janë arsye të tjera personale të studentëve, pasuar nga punësimi dhe arsye financiare. Arsyet e tjera bien më pak në sy. Të njëjtat arsye janë edhe për vitin 2019-2020, si dhe për vitin 2018-2019. Këto të dhëna tregojnë se migrimi i studentëve dhe në veçanti i të rinjve të Kosovës paraqet një problem serioz që duhet të trajtohet me prioritet nga ana e qeverisë së vendit. Më shqetësuese e bën edhe rritja e numrit nga viti në vit.

Megjithatë, nuk duhet harruar edhe ndikimi i pandemisë COVID-19 që mund të ketë ndikuar qoftë në mënyrë direkte apo indirekte në braktisjen e studentëve. UNESCO kishte vlerësuar në vitin 2020 se rreth 24 milionë nxënës, nga niveli parafillor në atë universitar, janë në rrezik të mos kthehen në shkollë në vitin 2020 pas ndërprerjes së arsimit për shkak të COVID-19. Pothuajse gjysma e tyre gjenden në Azinë Jugore dhe Perëndimore dhe në Afrikën Sub-Sahariane. Studentët e universitetit janë më të prekur, për shkak të kostove që lidhen me studimet e tyre. Arsimi parafillor është i dyti më i prekur, ndërsa në nivelin fillor dhe të mesëm 10.9 milionë nxënës janë në rrezik, 5.2 milionë prej të cilëve janë vajza. Faktorët socio-ekonomik qëndrojnë pas këtij rreziku, duke përfshirë nevojën për të gjeneruar të ardhura, rritjen e përgjegjësive për përkujdesjen e familjes dhe fëmijëve, martesën e hershme dhe të detyruar dhe/ose shtatzëninë e paqëllimshme në kontekste të caktuara ose frikën e rishfaqjes së virusit. Ata që nuk kishin akses në arsimin në distancë gjatë izolimit janë gjithashtu në rrezik.


Referenca: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000373992>

RAPORTI DHE ARSYET E BRAKTISJEVE TË STUDIMEVE NDËR VITE




RAPORTET E BRAKTISJEVE TË STUDIMEVE NËPËR NJËSI AKADEMIKE


Raporti i braktisjeve në Fakultetin Juridik




Raporti i braktisjeve në Fakultetin e Ekonomisë



Raporti i braktisjeve në Fakultetin e Shkencave Komputerike




Raporti i braktisjeve në Fakultetin e Edukimit



Raporti i braktisjeve në Fakultetin e Filologjisë



Raporti i Braktisjeve në FSHJM



KRAHASIMI ME RAJONIN DHE EVROPËN

Sipas Rrjetit të të Dhënave Evropiane, shkalla e braktisjes së shkollës është më e lartë në vendet e Evropës Jugore, dhe përsëri më e lartë në Italinë Jugore sesa në pjesën tjetër të vendit, si dhe në periferi të qyteteve të mëdha.

Strategjia e BE-së, Europa 2020 synon një shkallë të braktisjes së hershme të shkollës jo më e lartë se 10 për qind deri në fund të vitit. Ky parametër, i matur me treguesin “të larguarit nga arsimi i hershëm”, përcakton përqindjen e personave nga 18 deri në 24 vjeç që kanë arritur maksimalisht një diplomë të shkollës së mesme.

Me rënien e shkallës së braktisjes në 10.3 për qind në vitin 2019, BE është mesatarisht afër arritjes së objektivit të saj. Në lidhje me gjininë, një fletë faktike tematike e prodhuar nga Komisioni Evropian në tetor 2017 raporton se vajzat tashmë e arritën objektivin në 2014.

Duke parë Italinë dhe Ballkanin, vendet e ish-Jugosllavisë kanë tejkaluar dukshëm Italinë dhe Shqipërinë në këtë fushë. Në vitin 2018 Shqipëria kishte një normë të braktisjes së hershme të shkollës prej 17.4 për qind, ndërsa Italia kishte një normë prej 14.5 për qind.

Kroacia ka shkallën më të ulët të braktisjes së hershme të shkollës si në Ballkan ashtu edhe në BE, me 3.3 për qind në 2018 dhe vetëm tre për qind në 2019. Sllovenia dhe Greqia janë gjithashtu shumë nën mesataren evropiane, me 4.6 dhe 4.1 për qind respektivisht. Megjithatë, “rrjeti i informacionit arsimor” i Evropës Eurydice raporton se në Greqi një hendek i madh ndan shkallët e ulëta të braktisjes së shkollës në qendrat urbane dhe normat shumë më të larta në zonat rurale.

Reference: <https://www.europeandatajournalism.eu/eng/News/Data-news/School-dropouts-Croatia-among-the-lowest-rates-far-ahead-of-the-EU-and-Italy>

STRATEGJITË E UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTP” PRIZREN PËR ZVOGËLIMIN E BRAKTISJEVE

KËSHILLIMI AKADEMIK

Universiteti do të angazhojë në secilën njësi akademike këshilltarët akademik për studentë vetëm për qëllimin e ndihmës së studentëve rreth lëndëve të ndryshme, literaturës, mbështetje në zhvillim profesional dhe në karrierë gjatë studimeve të tyre, prej regjistrimit deri në diplomim. Këshilltarët akademik për studentë do të jenë pjesë e stafit akademik të njësisë akademike. Këshilltarët akademik do të bashkëpunojnë me Qendrën e Karrierës së Universitetit dhe do t'i bashkërendojnë aktivitetet e nevojshme. Këshilltarët akademik do t'i udhëzojnë studentët ku mund të sigurojnë ndihmë shtesë për kërkesat e tyre gjatë studimeve.

KËSHILLAT PSIKOLOGJIKE

Universiteti do t'u ndihmojë studentëve lidhur me shqetësimet personale, emocionale dhe psikologjike. Shërbimi do të jetë falas për të gjithë studentët . Psikologja është e angazhuar me vendim të Këshillit Drejtues për t'u shërbyer me këshilla psikologjike.

Universiteti nuk është në gjendje të ofrojë mbështetje për kushte afatgjata ose në rast të një situatë krize. Për këtë arsye studentëve ju rekomandojmë që të vizitoni Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren, e cila gjendet vetëm pak metra larg Kampusit Universitar. Ky është një institucion publik profesional shtetëror që ofron shërbime falas: Adresa: QSHM Rr.Xhevat Berisha P.N <https://goo.gl/maps/Z9GTQOtKprhYZQcx6>

ANGAZHIMI I STUDENTËVE TUTOR

Studentët tutor do të angazhohen për secilin program studimor. Ata do t'u shërbejnë studentëve të programit studimor duke ndihmuar për sukses akademik dhe mos braktisjen e studimeve. Përgjegjësi kryesore e një tutori është të mbështesë studentët (tutët) që të bëhen student më të pavarur, të vazhdojnë në Universitet dhe të arrijnë qëllimet e tyre. Tutorët ofrojnë mësim individual dhe/ose grupe për studentët në një gamë të gjerë kursesh bazuar në fushën e tyre personale të ekspertizës. Tutorët takohen me studentët për të sqaruar dhe rishikuar konceptet e mësuara në klasë, për të shpjeguar proceset dhe për të ndihmuar nxënësit zgjidhin probleme specifike. Mësimi mbështet aktivitetet e përqëndruara në klasë, dhe si i tillë, theksi dhe përmbajtja e sesioneve të tutorizimit përcaktohet nga nevojat e studentit. Tutorët punojnë me kolegët dhe këshilltarin akademik të njësisë akademike për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional.

QENDRA E KARRIERËS MBËSHTJE PËR SOFT-SKILLS

Qendra e Karrierës do të ofrojë vazhdimisht mbështetje për studentët e secilës njësi akademike që nga regjistrimi përmes organizimeve të trajnimeve të ndryshme për shkathtësi të buta dhe aktivitete jashtëkurrikulare me Parlamentin Studentor.

MËSIMI HIBRID

Universiteti në të ardhmen planifikon që të mundësojë organizimin e mësimit hibrid për studentët që punojnë. Krahas mësimit në klasë, do të përshtaten klasat, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të kyçen edhe online për të ndjekur kurset e tyre dhe të mos braktisin studimet për shkak të pamundësisë për pjesëmarrje në ligjërata.

LIGJËRATA SHITESË TË INDIVIDUALIZUARA

Studentët që kanë hasur në vështirësi në lëndë të caktuara, varësisht prej kërkesave dhe të propozimeve të studentëve tutor dhe këshilltarëve akademik, do të organizohen orë shtesë në fund të semestrit.

PLANI I VEPRIMIT 2023

Afati kohor	Aktiviteti
<input type="checkbox"/> January – March 2023	Angazhimi i këshilltarëve akademik në njësi akademike
<input type="checkbox"/> February 2023	Angazhimi i studentëve tutor në njësi akademike
<input type="checkbox"/> January 2023	Angazhimi i konsultave psikologjike
<input type="checkbox"/> February – June 2023	Aktivitete Qendra e Karrierës Kurse për shkathësi të buta dhe jashtëkurrikulare
<input type="checkbox"/> September – December 2023	Aktivitete Qendra e Karrierës Kurse për shkathësi të buta dhe jashtëkurrikulare
<input type="checkbox"/> October 2023	Mësimi hibrid në fakultete, sipas njësive akademike fillon të pilotohet në lëndë të caktuara
<input type="checkbox"/> October 2023	Profesorët fillojnë të mbajnë orë shtesë të individualizuara me studentët që kanë vështirësi në lëndë të caktuar
<input type="checkbox"/>	
<input type="checkbox"/>	
<input type="checkbox"/>	